



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

Këshilli Drejtues i Universitetit

Pejë, __.11.2025

Këshilli Drejtues i Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, mbi bazën e konsideratave humane, promovimit të mundësive të barabarta dhe stimulimit të të gjithë studentëve, në mbledhjen e mbajtur më 14.11.2025, mori vendim të shpallë këtë:

THIRRJE

për mbështetje financiare të studentëve të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, të cilët i përkasin kategorisë së personave me nevoja të veçanta

I. Kushtet e përgjithshme

1. Mbështetja financiare do të jepet për secilin student me nevoja të veçanta, në lartësi prej 1,200.00 € (njëmijë e dyqind euro).
2. Të drejtë aplikimi për mbështetje financiare kanë studentët të cilët i plotësojnë këto kushte:
 - 2.1. Të jenë studentë aktivë të fakulteteve të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë;
 - 2.2. Të jenë të regjistruar së paku në vitin e dytë të studimeve;
 - 2.3. T'i përkasin kategorisë së personave me nevoja të veçanta, sipas përkufizimeve dhe përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

II. Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim

1. Studentët të cilët i plotësojnë kushtet nga pika një (I) e këtij konkursi, aplikimin duhet ta bëjnë përmes adresës zyrtare elektronike: apliko.online@unhz.eu.
2. Dokumentet e nevojshme për aplikim janë:
 - 2.1. Kërkesa për aplikim;
 - 2.2. Vërtetimi për statusin e studentit të lëshuar nga njësi akademike përkatëse, si dëshmi për regjistrimin e semestrit dimëror të vitit akademik 2025/26;
 - 2.3. Dokumenti (certifikata) i lëshuar nga institucioni i autorizuar, me të cilin vërtetohet statusi i subjektit si person me nevoja të veçanta.

3. Studenti obligohet që Fletë aplikacionin, bashkë me dokumentacionin tjetër si në pikën 2, t'i dorëzojë në formë elektronike, brenda afatit të paraparë të thirrjes.
4. Zyra për Çështje Studentore në Administratën Qendrore, është e obliguar që brenda afatit prej dyzet e tetë (48) orësh nga dita e përfundimit të thirrjes, ta përgatis listën e studentëve të cilët i plotësojnë kriteret për përfitim të mbështetjes financiare, për shqyrtim dhe miratim nga Këshilli Drejtues.
5. Përgjegjësinë për saktësinë e të dhënave e bart aplikuesi.
6. Mbështetja financiare për vitin akademik 2025/26, ndahet për studentët e të gjitha niveleve dhe programeve të studimit, të cilët i përkatësin kategorisë së personave me nevoja të veçanta.

III. Mënyra dhe afati i aplikimit

1. Aplikimi bëhet formë elektronike në adresën zyrtare elektronike: apliko.online@unhz.eu, prej datës **17.11.2025** deri me datë **24.11.2025, në orën 16:00**.
2. Deklarimi i rrejtshëm përbën shkas për përjashtimin nga procedura e aplikimit dhe nisje të procedurave disiplinore sipas legjislacionit në fuqi.
3. Aplikimi bëhet vetëm përmes adresës zyrtare elektronike të studentit, të krijuar nga Universiteti: emri.mbiemri@student.unhz.eu. Problemet lidhur me qasjen apo të tjera të natyrës teknike, i adresohen Zyrës për Teknologji të Informacionit, përmes adresës zyrtare elektronike: web@unhz.eu.
4. Aplikimet e pasafatshme nuk do të shqyrtohen, ndërsa ato të mangëta do të refuzohen.

IV. Afati i ankesave

1. Studentët të cilët konsiderojnë se kanë pasur të drejtë përfitimi të mbështetjes financiare dhe nuk janë përfshirë në listën e përfituesve, kanë të drejtë ankese pranë Komisionit për shqyrtimin e kërkesave dhe parashtresave të tjera të Këshillit Drejtues, në afat prej dyzet e tetë (48) orësh pas ditës së publikimit të listave.
2. Ankesat dorëzohen në Zyrën për Protokollim dhe Arkiv (nr. 13), Ndërtesa e Rektoratit, Rr. UÇK, 30000, Pejë, Republika e Kosovës.
3. Ankesat e pasafatshme nuk do të merren në shqyrtim.

V. Publikimi

Vendimi do të publikohet në tabelat e shpalljeve dhe ueb faqet e fakulteteve, si dhe në ueb faqen e Universitetit: www.unhz.eu.